



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë,

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 221/5 Prot.

Tiranë, më 05.12.2017

V E N D I M

Nr.236, Datë 05/12/2017

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Kukës,

VËREJ SE:

Me Vendimin nr. 55, datë 21.3.2017, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Kukës", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, në institucionin Bashkia Kukës.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 221/1 prot., datë 21.3.2017, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 221/2 prot., datë 21.3.2017, "Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Bashkinë Kukës", i është njoftuar Bashkisë Kukës.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999, "Statusi i nëpunësit civil", (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 221/3 prot., datë 18.10.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “*Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Kukës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil*”, duke i lënë një afat 20 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr. 4006/1 prot., datë 02.11.2017, “*Dërgim projekt raporti*”, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, bashkëlidhur edhe observacionin, duke paraqitur sqarime dhe duke u shprehur dakord në lidhje me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Kukës, dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Të konstatohet pavlefshmëria absolute e akteve të emërimit (102 raste) nga Kryetari i Bashkisë Kukës, sipas orientimeve në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe të rregullohen pasojat, duke i ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin, punonjësve të emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit:
 - ✓ *****, “*Sekretar i Përgjithshëm*” (punësuar me aktin e emërimit nr. 03, datë 27.07.2015);
 - ✓ *****, “*Specialist Sektori i Financës*” (punësuar me aktin e emërimit nr. 278, datë 26.05.2016.);

- ✓ *****, "Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore" (punësuar me aktin e emërimit nr. 439, datë 01.09.2016);
- ✓ *****, "Shef i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore" (punësuar me aktin e emërimit nr. 99, datë 11.02.2016);
- ✓ *****, "Specialist i të Ardhurave" (punësuar me aktin e emërimit nr. 442, datë 01.09.2016);
- ✓ *****, "Shef i Sektorit të Regjistratit Tatimor dhe Kontrollit të Territorit" (punësuar me aktin e emërimit nr. 121, datë 16.02.2016);
- ✓ *****, "Specialist i Kontrollit të Territorit" (punësuar me aktin e emërimit nr. 17/1, datë 01.02.2017);
- ✓ *****, "Specialist i Kontrollit të Territorit" (punësuar me aktin e emërimit nr. 16/1, datë 01.02.2017);
- ✓ *****, "Specialist i Kontrollit të Territorit" (punësuar me aktin e emërimit nr. 15/1, datë 01.02.2017);
- ✓ *****, "Drejtor, Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore" (punësuar me aktin e emërimit nr. 106, datë 11.02.2016);
- ✓ *****, "Specialist i Multimedias" (punësuar me aktin e emërimit nr. 63, datë 27.01.2016);
- ✓ *****, "Drejtor, Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit" (punësuar me aktin e emërimit nr. 105, datë 11.02.2016);
- ✓ *****, "Shef i Sektorit të Planifikimit të Territorit" (punësuar me aktin e emërimit nr. 87, datë 03.02.2016);
- ✓ *****, "Specialist Topograf" (punësuar me aktin e emërimit nr. 181, datë 01.04.2016);
- ✓ *****, "Specialiste e Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës" (punësuar me aktin e emërimit nr. 92, datë 08.02.2016);
- ✓ *****, "Drejtor i Auditit të Brendshëm" (punësuar me aktin e emërimit nr. 05, datë 29.07.2015);
- ✓ *****, "Drejtor, Drejtorja e Ndhmës Ekonomike dhe Ndhmës Sociale" (punësuar me aktin e emërimit nr. 33, datë 06.08.2015);
- ✓ *****, "Shef i Sektorit të Shërbimeve Sociale dhe Strehimit" (punësuar me aktin e emërimit nr. 48, datë 01.04.2015);
- ✓ *****, "Punonjëse Sociale" (punësuar me aktin e emërimit nr. 109, datë 11.02.2016);
- ✓ *****, "Drejtor, Drejtorja e Koordinimit të Politikave Rinore dhe Projekteve" (punësuar me aktin e emërimit nr. 114, datë 18.02.2016);
- ✓ *****, "Specialist për Zhvillimin e Politikave Rinore" (punësuar me aktin e emërimit nr. 161, datë 18.03.2016);
- ✓ *****, "Specialist i Shërbimeve Publike" (punësuar me aktin e emërimit nr. 294, datë 01.06.2016);
- ✓ *****, "Specialist i Shërbimeve Publike" (punësuar me aktin e emërimit nr. 516, datë 11.10.2016);

- ✓ ***** , "Specialist i Shërbimeve Publike"(punësuar me aktin e emërimit nr. 418, datë 02.08.2016);
- ✓ ***** , "Specialist i Shërbimit Zoo-veterinar"(punësuar me aktin e emërimit nr. 138, datë 29.09.2015);
- ✓ ***** , "Shef i Sektorit të Shërbimeve Publike"(punësuar me aktin e emërimit nr. 342, datë 16.06.2016);
- ✓ ***** , "Drejtor, Drejtoria e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave"(punësuar me aktin e emërimit nr. 16, datë 18.01.2016);
- ✓ ***** , "Specialist i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave"(punësuar me aktin e emërimit nr. 79, datë 01.02.2016);
- ✓ ***** , "Drejtor, Drejtoria e Arsimit Parashkollor, QKF dhe Shërbimeve Mbashtetëse" (punësuar me aktin e emërimit nr. 158, datë 18.03.2016);
- ✓ ***** , "Shef i Sektorit të Çerdheve dhe Kopshteve"(punësuar me aktin e emërimit nr. 79, datë 01.02.2016);
- ✓ ***** , "Inspektor Kontrolli për Ushqimin dhe Shërbimin e Transportit" (punësuar me aktin e emërimit nr. 370/17, datë 01.07.2016);
- ✓ ***** , "Specialist i Programit dhe Vlerësimit të Politikave"(punësuar me aktin e emërimit nr. 70, datë 01.03.2017);
- ✓ ***** , "Specialist i Programit dhe Vlerësimit të Pronave"(punësuar me aktin e emërimit nr. 121, datë 15.03.2017);
- ✓ ***** , "Specialist i Shërbimeve Frutikulturë"(punësuar me aktin e emërimit nr. 120, datë 15.03.2017);
- ✓ ***** , "Drejtor, Agjencia e Parkut Natyror "Liqeni i Fierzës" dhe Turizmi" (punësuar me aktin e emërimit nr. 80, datë 06.03.2017);
- ✓ ***** , "Specialist për Biodiversitetin"(punësuar me aktin e emërimit nr. 81, datë 06.03.2017);
- ✓ ***** , "Specialist i Peshkimit"(punësuar me aktin e emërimit nr. 82, datë 06.03.2017);
- ✓ ***** , "Specialist Turizmi"(punësuar me aktin e emërimit nr. 79, datë 06.03.2017);
- ✓ ***** , "Specialist i Menaxhimit dhe Monitorimit të Parkut Natyror" (punësuar me aktin e emërimit nr. 88, datë 06.03.2017);
- ✓ ***** , "Specialist Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit"(punësuar me aktin e emërimit nr. 138/1, datë 29.02.2016);
- ✓ ***** , "Specialist Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit"(punësuar me aktin e emërimit nr. 233/1, datë 29.04.2016);
- ✓ ***** , "Specialist Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit"(punësuar me aktin e emërimit nr. 411/2, datë 01.08.2016);
- ✓ ***** , "Specialist Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit"(punësuar me aktin e emërimit nr. 539, datë 21.10.2016);
- ✓ ***** , "Specialist Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit"(punësuar me aktin e emërimit nr. 541, datë 01.11.2016);

- ✓ *****,"Specialist Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit"(punësuar me aktin e emërimit nr. 532/1, datë 31.10.2016);
- ✓ *****,"Drejtor Drejtoria e Tregut Ushqimor"(punësuar me aktin e emërimit nr. 471, datë 15.09.2016);
- ✓ *****,"Specialist Drejtoria e Tregut Ushqimor"(punësuar me aktin e emërimit nr. 470, datë 15.09.2016);
- ✓ *****,"Shef i Sektorit të Buxhetit"(punësuar me aktin e emërimit nr. 14/1, datë 01.02.2017);
- ✓ *****,"Specialist i Bashkëpunimit dhe Koordinimit"(punësuar me aktin e emërimit nr. 355, datë 23.06.2016);
- ✓ *****,"Specialist i të Ardhurave"(punësuar me aktin e emërimit nr. 104/1, datë 01.07.2014);
- ✓ *****,"Drejtor Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave" (punësuar me aktin e emërimit nr. 601, datë 12.12.2016);
- ✓ *****,"Specialist i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave"(punësuar me aktin e emërimit nr. 61/1, datë 01.03.2017);
- ✓ *****,"Specialist i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave"(punësuar me aktin e emërimit nr. 68, datë 01.03.2017);
- ✓ *****,"Specialist i Pyjeve dhe Kullotave"(punësuar me aktin e emërimit nr. 330, datë 13.06.2016);
- ✓ *****,"Specialist i Pyjeve dhe Kullotave" (punësuar me aktin e emërimit nr. 87, datë 06.03.2017);
- ✓ *****,"Specialist i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave"(punësuar me aktin e emërimit nr. 313, datë 13.06.2016);
- ✓ *****,"Drejtor Drejtoria e Rrugëve Rurale"(punësuar me aktin e emërimit nr. 312, datë 13.06.2016);
- ✓ *****,"Specialist i Hartimit të Projekteve"(punësuar me aktin e emërimit nr. 435, datë 31.08.2016);
- ✓ *****,"Punonjës Social"(punësuar me aktin e emërimit nr. 18/1, datë 29.01.2015);
- ✓ *****,"Punonjës Social"(punësuar me aktin e emërimit nr. 144, datë 01.10.2015);
- ✓ *****,"Punonjës Social"(punësuar me aktin e emërimit nr. 147, datë 05.10.2016);
- ✓ *****,"Punonjës Social"(punësuar me aktin e emërimit nr. 237/1, datë 29.01.2015);
- ✓ *****,"Punonjës Social"(punësuar me aktin e emërimit nr. 108, datë 11.02.2016);
- ✓ *****,"Specialist për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" (punësuar me aktin e emërimit nr. 331, datë 13.06.2013).

➤ **Njësia Administrative Tërthore**

- ✓ *****,"Specialist i Financës, Arkivist" (punësuar me aktin e emërimit nr. 227/1, datë 28.10.2015);

- ✓ *****,"*Specialist i Ndihmës Ekonomike*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 228/1, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"*Specialist i Bujqësisë dhe Pyjeve*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 229/1, datë 28.10.2015).

➤ **Njësia Administrative Shtiqën**

- ✓ *****," *Specialist i Financës, Arkivist*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 181, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"*Specialist i Ndihmës Ekonomike*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 180, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"*Specialist i Bujqësisë dhe Blegtorisë*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 183, datë 28.10.2015).

➤ **Njësia Administrative Shishtavec**

- ✓ *****," *Specialist i Financës, Arkivist*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 205, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"*Specialist i Ndihmës Ekonomike*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 203, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"*Specialist i Bujqësisë dhe Blegtorisë*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 218, datë 28.10.2015).

➤ **Njësia Administrative Malzi**

- ✓ *****," *Specialist i Financës, Arkivist*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 184, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"*Specialist i Ndihmës Ekonomike*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 185, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"*Specialist i Blegtorisë dhe i Pyjeve*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 186, datë 28.10.2015);

➤ **Njësia Administrative Kalis**

- ✓ *****," *Specialist i Financës, Arkivist*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 253/1, datë 12.05.2016);
- ✓ *****,"*Specialist i Ndihmës Ekonomike*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 85, datë 03.02.2016).

➤ **Njësia Administrative Gryk Cajë**

- ✓ *****,"*Specialist i Financës, Arkivist*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 228, datë 28.10.2015);

- ✓ *****,"Specialist i Ndhmës Ekonomike"(punësuar me aktin e emërimit nr. 229, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"Specialist Veteriner"(punësuar me aktin e emërimit nr. 230, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"Specialist Pyjesh"(punësuar me aktin e emërimit nr. 231, datë 28.10.2015).

➤ **Njësia Administrative Bushtricë**

- ✓ *****," Specialist i Financës, Arkivist" (punësuar me aktin e emërimit nr. 11/1, datë 16.01.2016);
- ✓ *****,"Specialist i Ndhmës Ekonomike" (punësuar me aktin e emërimit nr. 220, datë 28.10.2015).

➤ **Njësia Administrative Bicaj**

- ✓ *****," Specialiste e Financës, Arkiviste" (punësuar me aktin e emërimit nr. 193, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"Specialiste e Ndhmës Ekonomike" (punësuar me aktin e emërimit nr. 195, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"Specialiste e Ndhmës Ekonomike" (punësuar me aktin e emërimit nr. 202, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"Specialist Bujqësisë e Pyjesh" (punësuar me aktin e emërimit nr. 71, datë 01.03.2017);
- ✓ *****,"Specialiste Veterinere"(punësuar me aktin e emërimit nr. 196, datë 28.10.2015);

➤ **Njësia Administrative Arrën**

- ✓ *****," Specialist i Ndhmës Ekonomike, Arkivist" (punësuar me aktin e emërimit nr. 288, datë 28.10.2015);
- ✓ *****," Specialist i Administrimit të Pyjeve" (punësuar me aktin e emërimit nr. 210, datë 28.10.2015).

➤ **Njësia Administrative Zapod**

- ✓ *****," Specialiste e Financës, Arkiviste" (punësuar me aktin e emërimit nr. 216, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"Specialist i Ndhmës Ekonomike" (punësuar me aktin e emërimit nr. 217, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"Specialist i Bujqësisë dhe Pyjeve" (punësuar me aktin e emërimit nr. 218, datë 28.10.2015).

➤ **Njësia Administrative Ujmisht**

- ✓ *****," *Specialist i Financës, Arkivist*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 225, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"*Specialist i Ndihmës Ekonomike*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 67, datë 28.10.2015).

➤ **Njësia Administrative Topojan**

- ✓ *****," *Specialist i Financës, Arkivist*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 191, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"*Specialist i Ndihmës Ekonomike*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 190, datë 28.10.2015).

➤ **Njësia Administrative Surroj**

- ✓ *****," *Specialist i Financës, Arkivist*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 226, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"*Specialist i Ndihmës Ekonomike*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 226/1, datë 28.10.2015);

➤ **Njësia Administrative, Kolsh**

- ✓ *****,"*Specialiste e Financës, Arkiviste*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 226, datë 28.10.2015);
- ✓ *****,"*Specialiste e Ndihmës Ekonomike*" (punësuar me aktin e emërimit nr. 47, datë 15.02.2017).

Njësia përgjegjëse, të planifikojë ecurinë e procedurës për konstatimin si akte absolutisht të pavlefshëm, prej Kryetarit të Bashkisë, të akteve të emërimit për punonjësit e mësipërm, duke e realizuar këtë veprim administrativ në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.

Me qëllim që të mos pengohet veprimtaria normale e institucionit, në kushtet kur pothuajse të gjitha pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar në kundërshtim me ligjin, procesi i rregullimit të ligjshmërisë do të realizohet në dy faza, sipas planit që do të hartohet nga njësia përgjegjëse dhe do të miratohet nga Komisioneri.

Në zbatim të detyrimit ligjor, njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2018, planin e punës së pranimeve në shërbimin civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira pas ekzekutimit të këtij vendimi, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke mbajtur parasysh orientimet, në pikat më sipër të këtij vendimi.

Njësia përgjegjëse, të fillojë procesin e rekrutimit për pozicionet e lira në kuptim të ligjit, duke u kujdesur për përmbushjen e rregullave të përcaktuara në kreun IV, “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe duke u bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Në veçanti, njësia përgjegjëse në vijim të procesit, duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:

- ✓ Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimiit dhe vlerësimit (*Komiteti i Përherëshëm i Pranimiit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë*) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës, pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (*përveç lëvizjes paralele*) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.
 - ✓ Të bëhen publike në faqen zyrtare, “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në faqen zyrtare të Bashkisë Kukës dhe në stendat e njoftimeve për publikun, aktet si më poshtë:
 - a) Akti i shpalljes për plotësim, i pozicionit të lirë të punës në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të kreut II, e pikën 5, të kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, kreu II, të pikës 4, kreu VII, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin e përgjithshëm të pozicionit të punës, për të cilin do të zhvillohet konkurrimi; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimiit (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet, afatin dhe mënyrën e dorëzimit të tij; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe fushën e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjorë që duhet të përmbajë shpallja.
 - b) Akti i shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*” ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
 - c) Akti i shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (*lista përfundimtare*) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*” ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
 - d) Akti i shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.
3. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e

shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *”Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe të mbahen parasysh gjatë procesit të miratimit të strukturës përfundimtare të institucionit, si një detyrim ligjor që rrjedh prej ligjit që rregullon funksionimin e njësive vendore, i cili ka përcaktuar vitin 2018, si afatin e strukturimit përfundimtar të këtyre njësive, pas implementimit të reformës territoriale. Një kopje e përshkrimeve të punës, të depozitohet në arkivin e institucionit.

4. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të drejtojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve për vitin 2017, duke hartuar formularin e vlerësimit të punës për të gjithë nëpunësit civil të institucionit të bashkisë Kukës, tashmë të konfirmuar si të tillë, sipas formatit të miratuar dhe në mbështetje të kërkesave ligjore të përcaktuara, në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013 *”Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ”*. Formulari i plotësuar dhe i nënshkruar, duhet të depozitohet pranë njësisë së burimeve njerëzore, të institucionit.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil.

5. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, të nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit në kategorinë *“nëpunës civilë në periudhë prove”*, për punonjësin ***** në pozicionin *“Specialist i të Ardhurave”*, në Njësinë Administrative Surroj.
6. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrin qendror të personelit”*, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelat aneks, të cilat janë pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
8. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Kukës, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Kukës, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
10. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA